

Letra e të Drejtave për personat e mbajtur në paraburgim sipas Ligjit për Terrorizmin të vitit 2000

Kjo fletëpalosje ju jep informacion të rëndësishëm për të drejtat tuaja sipas ligjit në Skoci kur jeni në paraburgim në rajonin e policisë. Ky dokument ju tregon për të drejtat tuaja kryesore në paraburgim. Kjo nuk është këshillë ligjore dhe nuk ju tregon për të gjitha të drejtat tuaja. Ju duhet të kërkonit këshillën tuaj të pavarur ligjore.

Ju lutemi lexojeni këtë informacion sa më shpejt të jetë e mundur. Kjo do t'ju ndihmojë të merrni vendime kur jeni në rajonin e policisë. Ju lutemi kërkonit nga policia të shpjegojë çdo gjë që nuk e kuptoni në këtë broshurë, nëse dëshironi një kopje të lexueshme ose një përkthim të saj.

Mbani mend të drejtat tuaja:

- Ju keni të drejtë të dini pse policia po ju mban në paraburgim.
- Ju keni të drejtën të njoftoni një avokat që jeni në rajonin e policisë. Kjo është falas.
- Ju keni të drejtën që dikujt tjetër që mund të interesohet për mirëqenien tuaj t'i thuhet se jeni në polici. Për shembull, ky mund të jetë një anëtar i familjes, kujdestar ose një mik.
- Ju keni të drejtën të heshtni. Ju nuk jeni i detyruar t'i përgjigjeni asnjë pyetjeje që ju bën policia. POR ju duhet të jepni emrin, adresën, datën e lindjes, vendin ku keni lindur dhe kombësinë tuaj.
- Ju keni të drejtën të flisni me një avokat pa vonesë privatisht përpara se policia t'ju bëjë pyetje. Ju gjithashtu mund të flisni me një avokat në çdo kohë kur policia ju bën pyetje.
- Nëse jeni nën 16 ose nën 18 vjeç dhe i nënshtroheni një urdhri mbikëqyrjeje të detyrueshme, keni gjithashtu të drejtën të vizitoheni nga prindi ose kujdestari juaj në rajonin e policisë.
- Ju keni të drejtën për asistencë urgjente mjekësore.
- Ju keni të drejtën të ankoheni për mënyrën se si jeni trajtuar nga policia.

Të drejtat tuaja

Ju lutemi vini re: Në rrethana të jashtëzakonshme, policia ka të drejtë të vonojë ose të ndalojë aksesin tuaj në disa nga këto të drejta. Për shembull, nëse policia mendon se duhet të flasë me ju për të ndaluar lëndimin e një personi tjetër. **Kjo nuk përfshin të drejtën tuaj për të heshtur.**

1. Informacion për personat në paraburgim në polici

- **Të dini pse jeni arrestuar dhe pse mbaheni në paraburgim**

Policia duhet t'ju japë informacion në mënyrë që të kuptoni pse jeni arrestuar dhe dyshoheni se jeni përfshirë në kryerjen, përgatitjen ose nxitjen e terrorizmit.

Në rajonin e policisë, policia duhet t'ju tregojë pse mendon se ju duhet të mbaheni në paraburgim.

Përpara se t'ju bëhet ndonjë pyetje në lidhje me përfshirjen tuaj të dyshuar në terrorizëm, policia duhet t'ju japë juve ose avokatit tuaj informacion të mjaftueshëm për atë që ata mendojnë se keni bërë, në mënyrë që të mbroni veten, por pa dëmtuar hetimin e policisë.

- **E drejta për heshtje**

Ju nuk jeni i detyruar t'i përgjigjeni asnjë pyetjeje që ju bën policia për atë që ata mendojnë se keni bërë.

Çdo gjë që ju thoni do të shkruhet ose regjistrohet dhe mund të përdoret si provë në gjyq, nëse çështja juaj dërgohet në gjykatë.

Ju duhet t'i tregoni policisë emrin dhe adresën tuaj, datën e lindjes, vendin e lindjes dhe kombësinë kur ju kërkojnë këto të dhëna.

- **T'i tregoni një avokati se jeni në rajonin e policisë**

Ju mund t'i kërkonti policisë t'i tregojë një avokati se jeni në rajonin e policisë. Ky mund të jetë avokati juaj ose, nëse nuk njihni avokat, avokati i gatshëm. Policia do të marrë masa që të kontaktohet një avokat sa më shpejt të jetë e mundur. Kjo është pa pagesë.

Ju keni të drejtë që dikujt tjetër që mund të interesohet për mirëqenien tuaj t'i thuhet se jeni në rajonin e policisë.

Ju mund t'i kërkonti policisë të kontaktojë dikë tjetër për t'i informuar se jeni në rajonin e policisë. Ky mund të jetë dikush në familjen tuaj, partneri juaj, kujdestari juaj, miku juaj ose një person tjetër që njihni. Ai do të kontaktojë dikë për ju sa më shpejt që të mundën.

Nëse jeni nën 16 vjeç (ose nën 18 vjeç dhe i nënshtroheni një urdhri mbikëqyrjeje të detyrueshme)

- Policia duhet të përpiqet të informojë prindin ose kujdestarin tuaj se jeni në një rajon policie.
- Prindi ose kujdestari juaj mund të vijnë dhe t'ju mbështesin në rajonin e policisë.

- **Sjellja e një përkthyesi për t'ju ndihmuar**

Nëse nuk flisni ose nuk kuptoni anglisht, policia do t'ju sjellë dikë që flet gjuhën tuaj (një përkthyes). Kjo është falas. Është e rëndësishme që të kuptoni se çfarë po thuhet në rajonin e policisë.

Nëse jeni i shurdhër ose keni vështirësi të komunikoni qartë, policia do të sjellë dikë që t'ju ndihmojë. Ky mund të jetë një përkthyes i gjuhës britanike të shenjave ose një profesionist tjetër i përshtatshëm. Kjo është falas.

- **Nëse nuk jeni britanik**

Nëse nuk jeni britanik, mund t'i kërkonti policisë që të kontaktojë me Komisionin tuaj të Lartë, Ambasadën ose Konsullatën, për t'u treguar se ku jeni dhe pse jeni në rajonin e policisë. Ata gjithashtu mund t'ju vizitojnë privatisht dhe të organizojnë që një avokat të takohet me ju.

- **Çfarë ndodh nëse akuzoheni?**

Nëse akuzoheni për një vepër penale, mund të liroheshi nga mbajtja ose mund të mbaheshi në rajonin e policisë dhe të dërgoheni në gjykatë ditën vijuese të punës. Ose mund të liroheshi nëse pranoni të paraqiteni në gjykatë në një datë të caktuar.

- **Aksesi në dokumentet**

Juve ose avokatit tuaj do t'ju jepet një shënim i provave të çështjes, nëse çështja juaj shkon në gjykatë. Kjo do t'ju lejojë juve ose avokatin tuaj të përgatisni mbrojtjen tuaj.

Ju keni të drejtën e një përkthimi të informacionit përkatës nëse nuk kuptoni anglisht.

- **Aksesi në asistencë mjekësore**

Policia do t'ju bëjë pyetje për shëndetin dhe mirëqenien tuaj. Është e rëndësishme t'i tregoni policisë nëse keni një problem mjekësor ose jeni duke marrë mjekim. Është gjithashtu e rëndësishme t'i tregoni policisë nëse keni ndonjë varësi nga droga ose alkooli ose nëse po mendoni të dëmtoni veten.

Policia mund të kërkojë nga një mjek që t'ju ekzaminojë. Kjo është për t'u siguruar që do të merrni kujdesin e duhur gjatë qëndrimit në paraburgim. Nëse mendoni se keni nevojë të vizitoheni te një mjek, atëherë tregojini policisë.

Nëse sëmureni, keni të drejtën për ndihmë mjekësore.

- **Ushqimi dhe pijet**

Uji do t'ju sigurohet sipas kërkesës. Do t'ju ofrohet ushqim nëse jeni në paraburgim për më shumë se katër orë. Nëse keni ndonjë kërkesë dietike ose fetare, atëherë tregojini policisë sa më shpejt që të jetë e mundur.

- **Bërja e një ankese**

Nëse dëshironi të ankoheni kur jeni në paraburgim, flisni me një inspektor ose me dikë të një rangu më të lartë. Nëse dëshironi të ankoheni pasi jeni liruar, mund të shkoni në çdo rajon policie ose telefononi numrin 101. Ju gjithashtu mund t'i kërkonti dikujt tjetër të bëjë një ankesë në emrin tuaj, për sa kohë që i keni dhënë pëlqimin tuaj me shkrim. Ky mund të jetë një prind, mik, partner ose dikush të cilit i besoni.

Nëse jeni lënduar ose plagosur nga një oficer policie gjatë arrestimit ose ndalimit nga policia, duhet të ankoheni pranë Departamentit të Standardeve Profesionale të Policisë së Skocisë.

Nëse keni nevojë për ndihmë shtesë (ju lutemi vini re, ky është informacion vetëm për një shërbim dhe nuk është një e drejtë):

Ju mund të keni nevojë për ndihmë për të kuptuar se çfarë po ndodh kur jeni në rajonin e policisë. Kjo ndihmë mund të ofrohet nga një person mbështetës i quajtur "Personi i rritur i përshtatshëm". Kjo mund të zbatohet për ju nëse keni një çrregullim mendor ose paaftësi në të mësuar. Flisni me policinë nëse mendoni se keni nevojë për këtë ndihmë.

Nëse policia mendon se keni nevojë për ndihmën e një Personi të rritur të përshtatshëm, do t'ju sjellë një të tillë, edhe nëse ju nuk e kërkon.

2. Informacion për personat që do të merren në pyetje nga policia

• Sjellja e një avokati për t'ju ndihmuar

Tregojini policisë nëse doni të flisni me një avokat. Policia do të kontaktojë një avokat për ju sa më shpejt të jetë e mundur.

Roli i një avokati është të mbrojë të drejtat tuaja dhe t'ju japë këshilla rreth ligjit.

Ju mund të zgjidhni të flisni me një avokat që njihni ose me avokatin e gatshëm. Ky avokat është i pavarur dhe nuk punon për policinë.

Avokati do t'ju tregojë nëse mund t'ju këshillojë falas ose nëse do t'ju duhet të paguani për këshillën. Nëse duhet të paguani, ai do të shpjegojë se sa do të kushtojë dhe si mund të paguani për të. Policia nuk do të paguajë për avokatin tuaj ose nuk do të flasë për mënyrën se si paguhet avokati juaj.

Ju lejohet të zhvillonin një bisedë private me një avokat përpara se policia t'ju bëjë pyetje, përveç rasteve kur ju duhen bërë pyetje urgjente për arsye sigurie.

Ju mund të ndryshoni mendje për të folur me një avokat në çdo kohë. Tregojini policisë sa më shpejt të jetë e mundur dhe ata do të kontaktojnë një avokat për ju.

Nëse avokati nuk vjen në rajonin e policisë kur ka thënë se do të vijë, ose ju nevojitet të flisni përsëri me avokatin, mund t'i kërkonin policisë që ta kontaktojë përsëri avokatin.

Ju keni të drejtën të keni avokatin në dhomë me ju kur policia ju bën pyetje, përveç rasteve kur ju duhen bërë pyetje urgjente përpara se avokati të marrë pjesë, për arsye sigurie.

• Sa kohë mund të mbaheni në paraburgim për t'u marrë në pyetje?

Policia mund t'ju mbajë në paraburgim për marrje në pyetje deri në 48 orë pa ju akuzuar për vepër penale. Herë pas here, një oficer i lartë policie duhet të shqyrtojë rastin tuaj për të parë nëse duhet të jeni ende në paraburgim. Ky quhet rishikim. Ju mund të mbaheni në paraburgim për më shumë se 48 orë vetëm nëse një gjykatë e lejon këtë. Gjykata mund të zgjasë periudhën e paraburgimit pa akuzë deri në një maksimum prej 14 ditësh nga arrestimi juaj. Në këto rrethana duhet t'ju jepet sa vijon:

- Një dokument me shkrim se është bërë kërkesa për zgjatjen e paraburgimit tuaj;
- Koha kur është bërë kërkesa;
- Koha kur kërkesa duhet të dëgjohet në gjykatë; dhe
- Arsyet/arsyet pse kërkohet mbajtja e mëtejshme në paraburgim.

Ju (dhe përfaqësuesit tuaj ligjor) duhet t'ju jepet një njoftim sa herë që bëhet një kërkesë për të zgjatur ose zgjatur më tej paraburgimin tuaj.

Ju dhe avokati juaj keni të drejtën të thoni atë që mendoni për këtë vendim, përveç nëse nuk jeni në gjendje të mirë. Një avokat mund t'ju këshillojë për këtë.

- **Vizitorët e pavarur të paraburgimit**

Ka anëtarë të komunitetit që lejohen të hyjnë në rajonet e policisë. Ata njihen si Vizitorë të pavarur të paraburgimit dhe veprojnë mbi baza vullnetare për t'u siguruar që personat në paraburgim trajtohen siç duhet dhe të kenë akses në të drejtat e tyre.

Ju nuk keni të drejtë të takoheni me një vizitor të pavarur të paraburgimit ose t'i kërkoni atij t'ju vizitojë, por një vizitor mund të kërkojë t'ju shohë. Nëse një Vizitor i pavarur i paraburgimit ju viziton gjatë kohës që jeni në paraburgim, ai do të veprojë në mënyrë të pavarur nga policia për të kontrolluar nëse janë mbrojtur mirëqenia dhe të drejtat tuaja. Është zgjedhja juaj nëse dëshironi të flisni me ta.